



STANDARDET E PËRGJITHSHME PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

MIRATOHET

MINISTËR

EVIS KUSHI



**STANDARDET E PËRGJITHSHME
PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL
SHKOLLOR**

Qershor , 2022

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor” u hartuan nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Hartimi i dokumentit u koordinua nga:

Esion Zgjana

Përgatitja e dokumentit:

Rezarta Pullazi

Orsjola Miha

Anisa Asllanaj

Ornela Belba

Jona Hila

Ermilinda Zgjana

Redaktimi letrar:

Zija Kurti

Redaktimi shkencor:

Esion Zgjana

Olta Jaçellari

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	3
PARATHËNIE	5
PËRCAKTIMI I TERMAVE TË PËRDORUR	7
HYRJE	9
Qëllimi	10
FUSHAT E STANDARDEVE TË PËRGJITHSHME PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL.....	12
PJESA I: STANDARDET E PËRGJITHSHME PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO- SOCIAL	14
STANDARDET QË PREKIN TË GJITHA ASPEKTET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE .	14
Fusha 1: Marrja e vendimeve të bazuara në të dhëna.....	14
Fusha 2: Konsultimi dhe bashkëpunimi	16
SHËRBIME DIREKTE: SHËRBIMET NË FUNKSION TË TË NXËNIT	18
Fusha 3: Ndërhyrje në funksion të rritjes së motivimit dhe të arritjes së potencialit të të nxënit	18
Fusha 4: Shërbimet dhe ndërhyrjet për mirëqenien social-emocionale, shëndetin mendor dhe sjelljen.....	20
SHËRBIMET INDIREKTE: SHËRBIMET E NIVELIT TË SISTEMEVE (NXËNËSIT, FAMILJET DHE SHKOLLAT)	22
Fusha 5: Puna në shkolla për të nxitur procesin e të nxënit.....	22
Fusha 6: Shërbimet për promovimin e shkollave të sigurta dhe mbështetëse	25
Fusha 7: Bashkëpunimi i familjes, i shkollës dhe i komunitetit	28
BAZAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLË	30

Fusha 8: Praktika të barabarta për kategori të ndryshme nxënësish.....	30
Fusha 9: Kërkimi dhe puna e bazuar në të dhëna.....	33
Fusha 10: Praktika juridike, etike dhe profesionale	35
PJESA II: PARIMET ORGANIZATIVE	37
Parimi organizues 1: Organizimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve.....	37
Parimi organizues 2: Klima	38
Parimi organizues 3: Burimet njerëzore dhe shërbimet mbështetëse	39
Parimi organizues 4: Komunikimi profesional	40
Parimi organizues 5: Mbikëqyrja/supervizimi, konsultimi me kolegët dhe mentorimi	41
Parimi organizues 6: Zhvillimi i vazhduar profesional dhe sistemet e njohjes.....	43
BIBLIOGRAFIA.....	45

PARATHËNIE

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psiko-sociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.

Hartimi i këtij dokumenti është mbështetur tërësisht, në praktikat më të mira ndërkombëtare, duke pasur parasysh edhe historikun e zhvillimit të strukturës së shërbimit psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument, përsa i përket përmbajtjes dhe strukturës së tij, është në të njëjtën linjë me dokumentet e hartuara nga Shoqata Kombëtare e Psikologjisë Shkollore në SHBA (NASP), si një nga shoqatat më prestigjioze në fushën e mirëqenies së nxënësve, në mjediset e institucioneve arsimore.

Modeli i ndjekur për hartimin e këtij dokumenti, është mbështetur në dokumente të cilat përfshijnë vetëm shërbimet e ofruara nga psikologët e shkollave, por duke pasur parasysh strukturën dhe funksionimin e shërbimit psiko-social shkollor në arsimin parauniversitar, pamundësinë e mbulimit me të dy pozicionet (psikolog shkollor dhe punonjës social) të një numri të lartë shkollash, lind nevojën që ky dokument të fokusohet në praktikën e punës në tërësi, të strukturës së shërbimit psiko-social në shkollë.

Në shkollat ku shërbimi psiko-social mbulohet nga të dy pozicionet e punës (psikolog shkollor dhe punonjës social), realizimi dhe përmbushja e treguesve bëhet, bazuar në kompetenca profesionale dhe në formimin akademik të profesionit përkatës. Rezultati i pritshëm i këtij dokumenti nuk është ofrimi i shërbimeve të diferencuara, por ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të integruara.

Kontekstualizimi i praktikave ndërkombëtare ka qenë një proces i cili ka marrë vëmendje të rëndësishme, bazuar në aktet ligjore në fuqi për arsimin parauniversitar, për funksionimin e shërbimit psiko-social, për profesionet e rregulluara, për mbrojtjen e të dhënave personale, për burimet njerëzore në dispozicion, për strukturën e institucioneve arsimore, për strukturën e njësisë së shërbimit psiko-social etj.

Procesi i planifikimit të hartimit të “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” filloi zyrtarisht në vitin 2021. Procesi i hartimit kaloi në disa faza kryesore, ku faza e parë ishte hulumtimi i praktikave ndërkombëtare për funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Pasi u përzgjedh literatura më bashkëkohore, duke marrë në konsideratë dhe institucionet të cilat kanë publikuar këto materiale burimore, u realizua përkthimi dhe përpunimi i materialeve burimore nga ekspertë të fushës, duke pasur në vëmendje dhe përshtatjen e terminologjisë së përdorur dhe kontekstin.

Procesi i hartimit të dokumentit u koordinua nga specialistët e fushës, të cilët hartuan draftet, rishikuan të gjitha komentet dhe sugjerimet që rezultuan nga intervistat, pyetësorët dhe fokus grupe.

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” do të shtojë përpjekjet për të mbështetur punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë, për të promovuar shërbime efektive dhe gjithëpërfshirëse. Përmes këtij dokumenti kryesor të politikës së funksionimit të shërbimit psiko-social, si një grup i unifikuar i parimeve dhe i standardeve profesionale, do të udhëzohen praktikantët profesionale dhe sjellja etike e punonjësve të shërbimit psiko-social në shkollë. Për më tepër, ky dokument përcakton praktikën bashkëkohore të ndërhyrjeve psiko-sociale në shkollë; promovon shërbimet gjithëpërfshirëse dhe të integruara për nxënësit, për familjet, për shkollat dhe për komunitetin dhe siguron bazën për të ardhmen e shërbimit psiko-social.

Pas kalimit të të gjitha fazave të hartimit, ky dokument është miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

PËRCAKTIMI I TERMAVE TË PËRDORUR

Advokim: Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë një detyrim të veçantë, për të folur për të drejtat dhe mirëqenien e nxënësve dhe të familjeve, për të siguruar një zë për nxënësit që nuk mund ose nuk duan të flasin për veten e tyre. Advokimi gjithashtu, ndodh kur punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin ekspertizën e tyre në psikologji/punë sociale dhe edukim, për të promovuar ndryshimet në shkolla, në sisteme dhe në ligje, ku përfituesit do të jenë nxënësit, shkollat, familja dhe komuniteti.

E dhënë personale: është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose i identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti, duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë, për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social

E dhënë sensitive: është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe për jetën seksuale.

Etika profesionale: përbëhet nga një sërë kodesh ose standardesh, që zbatohen për të gjitha profesionet.

Mentorimi: është partneritet zhvillimor, përmes të cilit një person ndan njohuritë, shkathtësitë, informacionet dhe perspektivat, për të përforcuar rritjen personale dhe profesionale të një personi tjetër.

Modeli ekosistemik: është modeli për vlerësim dhe ndërhyrje, për të vëzhguar sjelljen njerëzore në mjedisin social.

Nxënës me aftësi të kufizuar (AK): është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë

të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

Plan Edukativ Individual (PEI): i cili shërben për planifikimin e nevojave arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Regjistri i të dhënave: është dokument i punonjësit të shërbimit psiko-social, në të cilin dokumentohen të dhënat e personave që marrin shërbim.

Sistem arsimor (SA): është tërësia e institucioneve publike dhe private përgjegjëse për arsimin dhe edukimin.

Struktura për mbrojtjen e fëmijëve: i referohet Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në njësitë administrative vendore.

Supervizim administrativ: është procesi i supervizimit dhe mbikëqyrjes së rasteve të cilat janë në menaxhim të përbashkët me struktura të tjera jashtë shkollës.

Supervizim profesional: është procesi i supervizimit dhe mbikëqyrjes së ecures së rasteve të cilat janë në këshillim ose në mbikëqyrje, nga punonjësi i shërbimit psiko-social.

Supervizor: është punonjësi i shërbimit psiko-social i cili mundëson dhe mbështet punën e punonjësve të tjerë të shërbimit psiko-social, për të krijuar marrëdhënie profesionale efektive, për të zhvilluar praktika të mira dhe për të ushtruar gjykim profesional dhe maturi në vendimmarrje.

Shërbimi psiko-social shkollor (SHPSSH): është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore, për identifikimin dhe për trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore. Punonjës i shërbimit psiko-social në shkolla mund të jetë psikolog dhe/ose punonjës social.

Transmetim elektronik i të dhënave: është përcjellja e çdo informacioni në rrugë elektronike, drejt institucioneve apo personave me të cilët bashkëpunohet për menaxhimin e rasteve.

Vizioni i politikave të arsimit parauniversitar synon qasjen në një sistem arsimor, që ka për bazë nevojat dhe interesat e nxënësve, në krijimin e kushteve dhe të mundësive, për të ndërtuar njohuritë e tyre, aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria, që lejon nxënësit të zhvillohen në mënyrë të pavarur, për të kontribuar në mirëqenien e tyre dhe të shoqërisë në mënyrë konstruktive, për t'u përballur me sfidat e jetës.

Qëllimi kryesor i “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” është të fuqizojë punonjësit e shërbimit psiko-social, për të promovuar mirëqenien psiko-emocionale, fizike dhe sociale të nxënësve, si dhe të lehtësojë procesin e të nxënësve. Ky qëllim arrihet përmes edukimit të vlerave të integritetit, të diversitetit dhe të gjithëpërfshirjes, fokusimit të nxënësit, advokimit, marrëdhënieve bashkëpunuese, përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në synime vizionare.

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë punonjës të specializuar në mbështetje të ekipeve shkollore, si profesionistë që nxisin aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe vetërealizuar. Ata marrin vazhdimisht përgatitje të specializuar dhe të avancuar, e cila përfshin rritjen e kapaciteteve në fushën psiko-sociale dhe arsimim/edukim. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me familjet, me mësuesit, me drejtuesit e shkollave, me stafin pedagogjik dhe me profesionistë të tjerë, për të krijuar mjedise të sigurta, të shëndetshme dhe mbështetëse, që forcojnë lidhjet midis familjes, shkollës dhe komunitetit.

Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit, familjet dhe shkollat, përmes identifikimit të shërbimeve të nevojshme, në lidhje me shëndetin mendor dhe të sjelljes për të gjithë nxënësit; zbatimit të praktikave profesionale që mbështeten në përputhje me kontekstin kulturor; ofrimit të një vazhdimësie shërbimesh për nxënësit, për familjet dhe për shkollat, që nis nga parandalimi, ndërhyrja, vlerësimi dhe advokimi.

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” ofron një sërë standardesh të unifikuara, që orientojnë arsimin, praktikat dhe shërbimet profesionale të punonjësve të shërbimit psiko-social.

Këto standarde profesionale përcaktojnë ndërhyrjet bashkëkohore; promovojnë shërbimet e punonjësve të shërbimit psiko-social për nxënësit, për familjet dhe për shkollat dhe sigurojnë një bazë për të ardhmen e shërbimit psiko-social. Standardet përkrahin praktikat e duhura të punonjësve të shërbimit psiko-social, në funksion të rezultateve pozitive për nxënësit, për familjet dhe për shkollën në tërësi.

Qëllimi

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” siguron orientim për punonjësit e shërbimit psiko-social, për nxënësit, për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, për strukturën drejtuese të njësisë së shërbimeve psiko-sociale të shkollës (drejtuesi i NJSHPS-ës dhe supervizorët) dhe për marrësit e shërbimeve psiko-sociale në shkollë. Gjithashtu, përcakton se cilat shërbime janë të nevojshme për t’u ofruar nga punonjësit e shërbimit psiko-social. Përveç kësaj, ka për qëllim të rrisë kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social, në lidhje me praktikat e duhura profesionale, si dhe të stimulojë zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit.

Ky dokument adreson ofrimin e shërbimeve psiko-sociale shkollore brenda kontekstit të programeve dhe të mjediseve arsimore. Dokumenti fokusohet në sfidat e veçanta që lidhen me ofrimin e shërbimeve psiko-sociale në shkolla, për nxënësit dhe për familjet.

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” përfshin dy seksione kryesore që përshkruajnë përgjegjësitë e punonjësve të shërbimit psiko-social shkollor dhe strukturave përgjegjëse për arsimin. **Pjesa I: Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkollor** përshkruajnë secilën nga 10 fushat e standardeve të përgjithshme profesionale, në lidhje me shërbimet psiko-sociale të shkollës. **Pjesa II: Parimet organizative**

përshkruajnë mbështetjet dhe përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse që punësojnë psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë. Këto parime përshkruajnë kushtet organizative që duhet të përmbushen, për të siguruar ofrimin efektiv të shërbimeve psiko-sociale shkollore për nxënësit, për familjet dhe për shkollat.

Këto udhëzime shërbejnë si model për zhvillimin efektiv të programeve dhe të praktikave profesionale, në nivelin vendor, rajonal dhe lokal. 10 fushat e standardeve të përgjithshme profesionale ofrojnë një kuadër të përgjithshëm të kompetencave themelore që duhet të zotërojnë të gjithë punonjësit e shërbimit psiko-social.

Zbatimi i këtij dokumenti siguron fleksibilitet, duke i lejuar strukturat përkatëse dhe profesionistët, të zhvillojnë procedura, politika dhe organizime administrative, që plotësojnë nevojat e institucionit arsimor dhe dëshirën e profesionistit, për të vepruar brenda standardeve profesionale. Në të njëjtën kohë, dokumenti ka specifika të mjaftueshme, për të siguruar ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse.

FUSHAT E STANDARDEVE TË PËRGJITHSHME PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të integruara, në 10 fusha të standardeve të përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social. Edukimi universitar, në psikologji shkollë apo punë sociale, përgatit profesionistë me kompetencat themelore profesionale, përfshirë njohuritë dhe aftësitë në 10 fushat, si dhe aftësinë për të integruar njohuritë dhe për të aplikuar aftësitë profesionale, në të gjitha fushat e standardeve profesionale të shërbimeve shkollë. Pohimet e mëposhtme formojnë bazën e standardeve profesionale të shërbimit psiko-social në shkollë:

- Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri bazë, si për psikologjinë/punën sociale, ashtu edhe për arsimin/edukimin, duke përfshirë teoritë, modelet, hulumtimet, praktikat e bazuara në eksperiencë dhe strategjitë e zbatimit brenda fushave, si dhe aftësinë për të komunikuar mbi bazën e parimeve dhe të koncepteve të rëndësishme.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin aftësi dhe strategji efektive, për të ndihmuar nxënësit të kenë sukses në procesin e të nxënës, aftësi sociale, të sjelljes dhe emocionale.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, duke krijuar e duke mbajtur një mjedis të sigurt, mbështetës, motivues, efektiv, duke rritur bashkëpunimin me familjen, me shkollën dhe me komunitetin për të gjithë nxënësit.

- Punonjësit e shërbimit psiko-social demonstrojnë njohuri dhe aftësi të rëndësishme për praktikat profesionale dhe karakteristikat e punës në fushën e tyre.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurohen që njohuritë, aftësitë dhe praktikat e tyre profesionale, të reflektojnë mirëkuptim dhe respekt për diversitetin dhe të promovojnë shërbime efektive, advokim dhe drejtësi sociale për të gjithë nxënësit, për familjet dhe për shkollat.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social integrojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale në 10 fushat e standardeve profesionale të shërbimit psiko-social, pasi ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, që çojnë në rezultate të drejtpërdrejta, të matshme për nxënësit, familjet, shkollat dhe/ose përfituesit e tjerë.
- Fushat e standardeve profesionale të shërbimit psiko-social janë shumë të ndërlidhura dhe nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Përshkrimet e shkurtra dhe treguesit e standardeve profesionale, në secilën prej fushave të përmendura më poshtë, përshkruajnë fushat kryesore të njohurive dhe të aftësive, por nuk kanë për qëllim të pasqyrojnë gamën e gjerë të kompetencave të mundshme të punonjësve të shërbimit psiko-social.

Ky dokument është mbështetur në modelin e ngjashëm të Shoqatës Kombëtare të Psikologëve Shkollorë të SHBA-së dhe përshkruan shërbimet e ofruara nga punonjësit e shërbimit psiko-social për nxënësit, për familjet dhe për shkollat. Dokumenti promovon nivel të lartë profesional të ofrimit të shërbimeve, për të përmbushur nevojat specifike sociale, të sjelljes, emocionale dhe të të nxënësit, të të gjithë nxënësit. Sidoqoftë, mund të theksohet se përvoja e punës, edukimi dhe zhvillimi i vazhduar profesional mund të rezultojnë në aftësi specifike dhe në njohuri të avancuara të punonjësve të shërbimit psiko-social. Ndër grupet e punonjësve të shërbimit psiko-social në shkollë, jo të gjithë do të fitojnë dhe do të shfaqin të njëjtat aftësi dhe njohuri në të gjitha fushat e praktikës së punës. Sidoqoftë, të gjithë punonjësit e shërbimit psiko-social pritet të kenë të paktën një nivel bazë të kompetencës, në të gjitha fushat e praktikës të përshkruara në këtë dokument.

PJESA I: STANDARDET E PËRGJITHSHME PROFESIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

STANDARDET QË PREKIN TË GJITHA ASPEKTET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Fusha 1: Marrja e vendimeve të bazuara në të dhëna

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dhe përdorin metoda vlerësimi, për identifikimin e nevojave dhe të pikave të forta për zhvillimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve, të programeve efektive, për matjen e progresit dhe të rezultateve, brenda një sistemi mbështetës me shumë nivele. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një model për zgjidhjen e problemeve, si bazë për të gjitha shërbimet profesionale të ofruara. Punonjësit e shërbimit psiko-social sistematikisht, mbledhin të dhëna nga burime të shumta, si bazë për vendimmarrjen në nivele individuale, grupi dhe sistemi, dhe konsiderojnë faktorët ekosistemik (p.sh. klasa, karakteristikat e familjes dhe të komunitetit), si kontekst për procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes.

Treguesit e fushës:

1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna nga burime të shumta (p.sh. prindër/persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, mësues, nxënës) dhe të dhëna në nivele individuale, grup, sistem, për të kuptuar nevojat e nxënësve, me qëllim përzgjedhjen e ndërhyrjeve dhe

mbështetjen e nevojshme.

- 1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të një ekipi multidisiplinar pranë njësisë vendore arsimore, kryejnë vlerësime, për të përcaktuar nevojën e nxënësve për shërbime, përfshirë përshtatshmërinë për arsim të zakonshëm ose special dhe për hartimin e planeve të edukimit individual (PEI), sipas nevojave të vlerësuara.
- 1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social përfshijnë teknika të ndryshme për mbledhjen, për matjen, për analizën, për raportimin e të dhënave, përdorimin e tyre me përgjegjshmëri dhe përdorimin e burimeve teknologjike, në vlerësimin e shërbimeve në nivel individual, në grup dhe/ose sistemesh.
- 1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin të dhëna, për të monitoruar përparimin në procesin e të nxënësve, social, emocional dhe të sjelljes, për të vlerësuar ecurinë e nxënësve, për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve, si dhe për të përcaktuar kur duhet të modifikojnë ose të ndryshojnë një ndërhyrje.
- 1.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje për mësuesit në klasë, për stafin e shkollës dhe për palët e tjera të interesuara, në mbledhjen, në analizimin dhe në interpretimin e të dhënave të përgjithshme, në monitorimin e progresit, për të lehtësuar vendimmarrjen në lidhje me nevojat e nxënësve.
- 1.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në hartimin, administrimin dhe interpretimin e të dhënave të vlerësimit, për të përcaktuar shkallën në të cilën janë zbatuar ndërhyrjet e rekomanduara.
- 1.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin përdorimin e metodave të besueshme dhe të vlefshme të mbledhjes së të dhënave, për vlerësimin e efektivitetit dhe/ose nevojës, për modifikim të ndërhyrjeve dhe të programeve të bazuara në shkollë.
- 1.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin burimet e informacionit në terren dhe të teknologjisë, me qëllim mbledhjen e të dhënave, për një vendimarrje efektive, në funksion të ndërhyrjes.

Fusha 2: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dhe aplikojnë modele dhe strategji të ndryshme konsultimi dhe bashkëpunimi, të zbatueshme për individët, familjet, grupet dhe sistemet, si dhe metoda për të promovuar zbatimin efektiv të shërbimeve, si pjesë e një procesi sistematik dhe gjithëpërfshirës të vendimmarrjes efektive dhe të zgjidhjes së problemeve, që përfshin të gjitha aspektet e ofrimit të shërbimeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social tregojnë se zotërojnë aftësi për t'u konsultuar, për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar në mënyrë efektive me të tjerët.

Treguesit e fushës:

- 2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një proces të gjerë konsultativ të zgjidhjes së problemeve, si mjet për planifikimin, për zbatimin dhe për vlerësimin e shërbimeve shkollore, të shëndetit mendor dhe të sjelljes.
- 2.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë në mënyrë efektive informacionin verbal dhe me shkrim, për grupe të ndryshme interesi, të tillë si: prindërit, mësuesit, personeli i shkollës, politikëbërësit, drejtuesit e shkollës etj.
- 2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social konsultohen dhe bashkëpunojnë me profesionistë arsimorë, me familjet, me grupet dhe me sistemet, në nivel individual dhe grupi, duke marrë parasysh pikëpamjet e të gjitha palëve të përfshira, kur marrin vendime.
- 2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social lehtësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve, duke demonstruar teknika efektive dhe të përshtatshme të komunikimit ndërpersonal.
- 2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në një sërë strukturash drejtuese me bazë shkolle apo të njërive vendore arsimore, për të lehtësuar dhe për të promovuar rezultate pozitive për nxënësin, për stafin e shkollës dhe për sistemin arsimor.
- 2.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social konsultohen dhe bashkëpunojnë me profesionistë të disiplinave të ndryshme, për të ndarë të dhëna, informacione, eksperiencë në funksion të përmirësimit të praktikave.

2.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social funksionojnë duke përdorur aftësitë e tyre në komunikim, në bashkëpunim dhe në konsultim, duke ndikuar në fuqizimin dhe inkurajimin e nxënësve me qëllim orientimin e tyre drejt modeleve më të suksesshme të sjelljes .

2.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social zbatojnë parimet psiko-sociale dhe edukative të nevojshme, për të rritur bashkëpunimin dhe efektivitetin në ofrimin e shërbimeve.

SHËRBIME DIREKTE: SHËRBIMET NË FUNKSION TË TË NXËNIT

Fusha 3: Ndërhyrje në funksion të rritjes së motivimit dhe të arritjes së potencialit të të nxënit

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin ndikimet e faktorëve biologjikë, kulturorë dhe socialë, në aftësitë e të nxënit; në procesin e zhvillimit, në aftësinë njohëse (kognicionin) dhe ofrojnë mbështetje dhe ndërhyrje për nxënësit, këshillim për mësuesin, për familjet; bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë të qendrave komunitare të shëndetit mendor, me qëllim që të përmirësojnë strategjitë e mbështetjes, si dhe bashkëpunojnë me anëtarë të tjerë të shkollës dhe të komunitetit, për të koordinuar shërbimet e nevojshme në funksion të të nxënit. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë arsimorë (stafin pedagogjik), përdorin metoda të vlerësimit dhe të mbledhjes së të dhënave, për të zbatuar dhe për të vlerësuar shërbimet që mbështesin zhvillimin e kompetencave të nxënësit.

Treguesit e fushës:

- 3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin të dhënat e marra nga stafi i shkollës, për të ndërtuar strategji që kanë për qëllim përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
- 3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë ndërhyrje dhe lehtësime, për të ndihmuar nxënësit të rrisin kapacitetin e tyre për vetëmenaxhimin, duke rritur aftësinë e tyre për vendosjen dhe për arritjen e qëllime mësimore, vlerësimin e arritjeve në përmbushjen e rezultateve të pritshme, në mënyrë që të përcaktojnë nëse objektivat janë arritur.
- 3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin pedagogjik, për të siguruar që nxënësit, arritjet e të cilëve nuk përputhen me potencialin e tyre të të nxënit, të monitorojnë vazhdimisht ecurinë e tyre për të përmirësuar aftësitë

e të nxënësve në funksion të përparimit dhe në rastet e nevojshme të rekomandojnë ndryshimet në udhëzime duke u bazuar në reagimet e nxënësve ndaj ndërhyrjeve.

- 3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social, bazuar në nevoja të vlerësuara edhe në rezultatet e kërkimeve aktuale, ndërhyjnë në zhvillimin e metodologjive efektive dhe promovojnë të nxënësve në nivel individual dhe grupi.
- 3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin pedagogjik, për të vlerësuar, për të zhvilluar dhe për të zbatuar ndërhyrje efektive, me qëllim përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.
- 3.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin të gjithë informacionin që kanë në dispozicion dhe njohuritë e tyre, në zhvillimin e metodologjive të mësimdhënies, për të përmbushur nevojat individuale të të nxënësve.
- 3.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin të dhënat e vlerësimit, për të zgjedhur dhe për të zbatuar ndërhyrje efikase, bazuar në nevojat e identifikuar, për të nxitur zhvillimin e të nxënësve.
- 3.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social lehtësojnë zbatimin e kurrikulës dhe të metodologjive të mësimdhënies, bazuar në të dhëna që promovojnë arritjet në lexim-shkrim, në matematikë dhe në fusha të tjera të përmbajtjes, përmes teknikave, të tilla si: udhëzim i drejtuar nga mësuesi, mentorim nga bashkëmoshatarët dhe ndërhyrje për vetërregullim, për planifikim/organizimin dhe për menaxhimin e kërkesave që lindin gjatë procesit të të nxënësve.
- 3.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin stafet pedagogjike përmes trajnimeve të ofruara që kanë për qëllim të orientojnë metodologjinë e tyre të mësimdhënies, në mënyrë të tillë që të jetë sa më motivuese, inkurajuese dhe tërheqëse për t'u përvetësuar nga nxënësit duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e performancës mësimore të nxënësve.

Fusha 4: Shërbimet dhe ndërhyrjet për mirëqenien social-emocionale, shëndetin mendor dhe sjelljen

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin ndikimet e faktorëve biologjikë, kulturorë, zhvillimorë dhe socialë në shëndetin mendor, emocionalë dhe të sjelljes dhe përdorin strategji të bazuara në të dhëna, për të promovuar funksionimin social-emocional.

Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, vlerësojnë, hartojnë, zbatojnë dhe ofrojnë shërbime që promovojnë sjelljen pozitive, krijimin e aftësive sociale dhe aftësive përballuese, që përmirësojnë shëndetin mendor dhe sjelljen.

Treguesit e fushës:

- 4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin faktorët e rrezikut dhe faktorët mbrojtës, gjithashtu përdorin të dhëna dhe vlerësime për të lehtësuar zbatimin e kurrikulave dhe të ndërhyrjeve, për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi efektive social-emocionale, të tilla si: reziliencën, vetëmonitorimin, vetadvokimin, planifikimin/organizimin, ndjeshmërinë, strategjitë pozitive të përballimit, aftësitë ndërpersonale dhe vendimmarrjen e shëndetshme.
- 4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social integrojnë shërbimet mbështetëse, bazuar në nevojat e vlerësuara. Duke përdorur të dhëna, ata identifikojnë nxënësit që kanë nevojë për mbështetje të individualizuar dhe ofrojnë ndërhyrje në funksion të mirëqenies psiko-emocionale dhe të sjelljes, në përputhje me zhvillimin, me moshën me kontekstin kulturor, duke përfshirë këshillimin individual dhe këshillim në grup, aftësimin dhe ndryshimin e sjelljes, të mësuarit të aftësive social-emocionale në klasë dhe në shkollë, përforcim të sjelljeve pozitive, si dhe ndërgjegjësimin e prindërve në mbështetje të fëmijëve. Kjo mund të përfshijë vëmendjen ndaj çështjeve, të tilla si: zhvillimi i aftësive adaptive, të aftësive të jetës dhe të ndërgjegjësimit për sigurinë personale.
- 4.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë dhe bashkëpunojnë me stafin pedagogjik, për të kuptuar dhe për të identifikuar ndikimin e traumës në

funksionimin shoqëror, emocional, të sjelljes, gjithashtu punojnë për të zbatuar praktikën dhe për të zvogëluar efektet e traumës në procesin e të nxënës dhe në sjellje.

- 4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin aftësitë që lidhen me analizën e sjelljes, me historikun shëndetësor, me dinamikën familjare, me kontekstin kulturor, me pasojat, me funksionet dhe me shkaqet e mundshme të vështirësive të sjelljes, që mund të pengojnë të mësuarin ose aftësitë sociale, si dhe marrin vendime efektive, bazuar në elementet e mësipërme. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë vështirësitë e sjelljes, që mund të rrjedhin nga aftësitë specifike dhe/ose mangësitë e performancës, e cila mund të përmirësohet përmes ndërhyrjeve dhe/ose strategjive përforcuese në bashkëpunim me shkollën, me familjen dhe me komunitetin.
- 4.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë dhe zbatojnë mbështetje pozitive të sjelljes në nivelet individuale, të grupit, të klasës dhe të shkollës, bazuar në qasje të përshtatshme ekosistemike dhe të sjelljes (p.sh.: përforsimi pozitiv, trajnimi i aftësive psiko-sociale, psikologjia pozitive, etj.); promovojnë praktika efektive të disiplinimit të nxënësve dhe strategji të menaxhimit të klasës.
- 4.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin të dhëna të marra nga vëzhgimet, referimet, evidenca, për të vlerësuar zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve për mirëqenien psiko-emocionale dhe të sjelljes, për individët dhe për grupet.
- 4.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin efektiv familje-shkollë dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunojnë me ofruesit e tjerë të shërbimeve në komunitet, për të koordinuar mbështetjen e shëndetit mendor dhe të sjelljes.

SHËRBIMET INDIREKTE: SHËRBIMET E NIVELIT TË SISTEMEVE (NXËNËSIT, FAMILJET DHE SHKOLLAT)

Fusha 5: Puna në shkolla për të nxitur procesin e të nxënës

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin strukturat, organizimin e sistemeve, programet e arsimit të përgjithshëm dhe special, si dhe praktika të bazuara në të dhëna nga burime të ndryshme, të cilat promovojnë të nxënës, sjelljen pozitive dhe mirëqenien psiko-emocionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me stafin pedagogjik, zhvillojnë dhe zbatojnë praktika dhe strategji, për të krijuar dhe për të mbajtur mjedise të sigurta, efektive dhe mbështetëse për nxënës dhe për stafin e shkollës.

Treguesit e fushës:

- 5.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, përfshihen në strategji të bazuara në të dhëna, në hartimin, në zbatimin dhe në vlerësimin e politikave dhe të praktikave në fusha, të tilla si: disiplina, vlerësimi i arritjeve, mbështetja mësimore, trajnimi i stafit, aktivitetet e përmirësimit të shkollës, vlerësimi i programit dhe partneritetet shkollë-familje.
- 5.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë zhvillim profesional, trajnim dhe orientim të vazhdueshëm, për një sërë tematikash që ndihmojnë stafin pedagogjik dhe prindërit/kujdestarët, të kuptojnë më mirë nevojat zhvillimore të nxënësve në shkolla, dhe që promovojnë përdorimin e metodologjive të mësimdhënies efektive, praktikat pozitive të menaxhimit të klasës dhe nxitjen e marrëdhënieve mbështetëse të punës.
- 5.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin njohuritë profesionale mbi strukturat përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për të ndihmuar në

promovimin e një klime respekti, mbështetëse në vendimmarrjen dhe në bashkëpunimin për mësimdhënie dhe për shërbime cilësore.

- 5.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë anëtarët e stafit pedagogjik, nxënësit dhe prindërit/kujdestarët, për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore dhe me respekt.
- 5.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen në vlerësimin dhe evidentimin e shkaqeve që pengojnë progresin akademik të nxënësve në shkollë dhe hartojnë plane ndërhyrjeje në nivel individual/grup për të ndihmuar fëmijën në kapërcimin e vështirësive.
- 5.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në kryerjen e vlerësimeve të nevojave, në përzgjedhjen e programeve të përshtatshme, bazuar në nevojat individuale të nxënësve.
- 5.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë për të lehtësuar kalimin e suksesshëm të nxënësve nga një mjedis në tjetrin (p.sh. nga shkolla në shkollë, nga klasa në klasë, nga cikli në cikël etj.) përmes informimit, këshillimit dhe zbatimit të planeve të ndërhyrjes në bashkëpunim me nxënësit, mësuesit dhe prindërit për të mbështetur nxënësit sipas nevojave.
- 5.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social punojnë me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, për të zhvilluar dhe për të ruajtur klimën pozitive të shkollës, si dhe mjedise mësimore që mbështesin progresin e vlerësimit të arritjeve dhe zvogëlojnë ndikimet negative në mësim dhe në sjellje.
- 5.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në hartimin dhe në zbatimin e procedurave për shërbime mbështetëse shtesë, për të promovuar mirëqenien.
- 5.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me personelin e shkollës, për të krijuar dhe për të mbajtur një sistem shërbimesh me shumë nivele, për të mbështetur arritjet në procesin e të nxënës, social-emocional dhe të sjelljes.
- 5.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë problemet e nivelit të sistemeve dhe identifikojnë faktorët që ndikojnë në të mësuarin dhe në sjelljen. Ata ndihmojnë drejtuesit e shkollave, të vlerësojnë rezultatet e klasës dhe mbështesin praktikën e përbashkët të vendimmarrjes, të krijuara për të



promovuar mirëqenien.

Fusha 6: Shërbimet për promovimin e shkollave të sigurta dhe mbështetëse

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin parimet dhe hulumtojnë në lidhje me mirëqenien psikologjike, sociale, emocionale; fuqizimin, faktorët e riskut, shëndetin mendor dhe sjelljen, shërbimet në shkolla dhe komunitete, për të mbështetur, për të parandaluar dhe për të promovuar mirëqenien e shëndetit në shumë nivele dhe strategji të bazuara në të dhëna, për krijimin e shkollave të sigurta dhe mbështetëse. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, promovojnë shërbime parandaluese që rrisin të nxënit, shëndetin mendor, sjelljen e përshtatshme dhe sigurinë psiko-sociale e fizike, dhe zbatojnë parandalimin efektiv të krizave, mbrojtjen, zbutjen, reagimin dhe fuqizimin nga krizat.

Treguesit e fushës:

- 6.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë shërbime që nxisin krijimin dhe ruajtjen e një klimë pozitive në shkollë, si dhe përdorin ekspertizën e tyre, për të ndërtuar dhe për të përmirësuar marrëdhëniet që lidhin më tepër nxënësit, stafin pedagogjik, familjet dhe komunitetet me shkollën.
- 6.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë mirëqenien dhe fuqizimin, duke:
 - a) bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, për të siguruar njohuri bazë të sjelljeve, që çojnë në zotërimin e aftësive vetërregulluese dhe të shëndetshme për nxënësit;
 - b) lehtësuar ndryshimet mjedisore, të favorshme për mirëqenien dhe për përshtatjen e nxënësve;
 - c) ofruar qasje në burime, për të adresuar një larmi të gjerë të nevojave, lidhur me sjelljen, të mësuarit, si dhe me nevojat mendore dhe fizike.
- 6.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbrojnë dhe promovojnë politikat shtetërore dhe lokale, që nxisin mjedise shkollore të sigurta dhe

gjithëpërfshirëse.

- 6.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social kontribuojnë për krijimin e mjediseve të sigurta dhe mbështetëse në shkolla, duke njohur dhe duke adresuar faktorët e riskut dhe ata mbrojtës, që janë jetikë për të kuptuar dhe për të trajtuar probleme, të tilla si: humbja e vitit shkollor, shpërndarja e nxënësve nga orët e mësimi, mungesat e shpeshë pa arsye, braktisja e shkollës, ngacmimet/fyerjet/talljet, dhuna në shkollë, abuzimi me substancat dhe sjelljet vetëdëmtoese të fëmijëve dhe të rinjtë. Ata ndërmarrin hapa për të promovuar strategji parandaluese dhe për të zhvilluar faktorët mbrojtës, që ndihmojnë në fuqizim.
- 6.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin monitorimin për treguesit e hershëm të rrezikut, punojnë për të ofruar shërbime konsultimi, ndërhyrje në mënyrë efektive për të ulur rrezikun e përfshirjes së nxënësve në sjellje të rrezikshme, promovojnë të mësuarin efektiv dhe mirëqenien e shëndetit mendor për të gjithë nxënësit.
- 6.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social kontribuojnë në hartimin, në zbatim dhe në vlerësimin e programeve parandaluese, që promovojnë shkolla dhe komunitete të sigurta, duke luftuar çdo formë dhune.
- 6.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në ekipet e reagimit ndaj krizave dhe emergjencave në shkollë dhe përdorin metoda vendimmarrëse, të bazuara në të dhëna, në strategji për zgjidhjen e problemeve, në konsultime, në bashkëpunime dhe në shërbime të drejtpërdrejta, në kontekstin e parandalimit të krizave, të mbrojtjes, të zbutjes së reagimit dhe të fuqizimit të komunitetit shkollor.
- 6.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë, për të kryer vlerësime të sigurisë në shkollë, për zhvillimin e planeve gjithëpërfshirëse të sigurisë individuale dhe të institucionit, me qëllim parandalimin dhe reagimin ndaj ngjarjeve të krizave dhe të emergjencave, për të zbutur efektet të nxënësve dhe të rriturit në komunitetin e shkollës.
- 6.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me profesionistë të tjerë, trajnojnë stafin pedagogjik dhe prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, si të njohin dhe si të reagojnë ndaj faktorëve të riskut që mund të

kërkojnë ndërhyrje nga personat përgjegjës për menaxhimin e krizave në shkollë.

6.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me profesionistë të tjerë, angazhohen dhe ndërhyjnë në rastet e krizave dhe të emergjencave, duke kryer vlerësime gjithëpërfshirëse të sjelljeve vetëdëmtuese dhe/ose kërcënimeve, për nxënësit që identifikohen si të rrezikuar, dhe hartojnë plane ndërhyrje, për të adresuar nevojat e shëndetit mendor dhe të sjelljes.

6.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me personelin e shkollës, me prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, me nxënësit dhe me strukturat për mbrojtjen e fëmijëve pranë njësive vendore administrative, për të siguruar mbështetje profesionale për mirëqenien mendore, psiko-emocionale dhe sociale, gjatë dhe pas situatave të krizës dhe të emergjencave.

Fusha 7: Bashkëpunimi i familjes, i shkollës dhe i komunitetit

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin parimet dhe kërkimet që lidhen me sistemet familjare, me pikat e forta, me nevojat dhe kulturat; njohin strategji të bazuara në të dhëna, për të mbështetur ndikimet pozitive të familjes në procesin e të nxënësve dhe në mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve; strategji për të zhvilluar bashkëpunimin midis familjeve dhe shkollave. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, vlerësojnë dhe ndërhyjnë me shërbime që i përgjigjen kulturës dhe kontekstit. Ata lehtësojnë partneritetin shkollë-familje dhe ndërveprimet me organizata/agjenci, për të përmirësuar gjendjen sociale dhe psiko-emocionale, me qëllim rritjen e rezultateve të të nxënësve dhe të sjelljes për nxënësit.

Treguesit e fushës:

- 7.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë, respektojnë dhe promovojnë diversitetin në sistemet familjare. Ata identifikojnë pikëpamjet e ndryshme, kontekstet kulturore dhe familjare dhe faktorë të tjerë, që kanë ndikim në partneritetin shkollë-familje dhe në ndërveprimet me komunitetin. Ata i marrin parasysh këta faktorë, kur zhvillojnë dhe ofrojnë shërbime për familjet.
- 7.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin strategji të bazuara në të dhëna, për të vlerësuar, për të hartuar dhe për të zbatuar politika dhe praktika efektive, që promovojnë partneritetin shkollë-familje-komunitetit, për rritjen e rezultateve të të nxënësve dhe përmirësimin e gjendjes psiko-emocionale dhe të sjelljes për nxënësit.
- 7.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me profesionistë të tjerë, promovojnë sigurinë, të ushqyerit, ambientin e sigurt e të besueshëm në familje, për të lehtësuar zhvillimin e shëndetshëm të nxënësve.
- 7.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social i mbajnë në konsideratë nevojat unike të nxënësve që jetojnë në mjedise jotradicionale, përfshirë ata që janë të pastrehë ose të zhvendosur dhe ata që jetojnë nën kujdestari, mjedise të përbashkëta

banimi ose strehim kalimtar. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, dhe me agjencitë e komunitetit që mbështesin këta nxënës.

7.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në krijimin e lidhjeve midis shkollave, familjeve e komunitetit dhe ndihmojnë në koordinimin e shërbimeve, kur programi individual për nxënësit përfshin aktorë të ndryshëm.

7.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social përkrahin sistemin e familjes dhe mbështesin prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, në përfshirjen e tyre në veprimtaritë shkollore, si për adresimin e nevojave individuale të nxënësve, ashtu edhe për pjesëmarrjen në ngjarjet e klasës dhe të shkollës. Ata pranojnë pengesat që mund të hasin prindërit, për t'u angazhuar në shkollë, dhe ndërmarrin hapa për t'i ndihmuar familjet t'i kapërcejnë ato.

7.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social edukojnë duke informuar komunitetin e shkollës, lidhur me ndikimin e përfshirjes së familjes në suksesin dhe arritjet në shkollë dhe advokojnë për përfshirjen e prindërve apo personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në qeverisjen e shkollës dhe në zhvillimin e politikave kur është e mundur.

BAZAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLË

Fusha 8: Praktika të barabarta për kategori të ndryshme nxënësish

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri e respekt për dallimet individuale, për aftësitë, për aftësitë e kufizuara dhe karakteristikat e tjera të ndryshme dhe efektet që ato kanë në zhvillimin dhe të nxënësve. Ata gjithashtu, njohin parimet dhe hulumtimet që lidhen me diversitetin e nxënësve, familjet, shkollat dhe komunitetet, duke përfshirë faktorët që lidhen me zhvillimin e nxënësve, me fenë, me kulturën dhe identitetin kulturor, me racën, me orientimin seksual, me identitetin dhe shprehjen gjinore, me statusin socio-ekonomik dhe me ndryshime të tjera. Punonjësit e shërbimit psiko-social zbatojnë strategji të bazuara në të dhëna, për të shtuar shërbimet, si në arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe në atë special, dhe për të adresuar ndikimet e mundshme që lidhen me diversitetin. Punonjësit e shërbimit psiko-social demonstrojnë aftësi, për të ofruar shërbime profesionale që promovojnë funksionim efektiv për individët, për familjet dhe për shkollat, me karakteristika, me kultura dhe me prejardhje të ndryshme etj. Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë se praktikat e barabarta për popullatat e ndryshme të nxënësve, respektimi i diversitetit dhe advokimi për drejtësinë sociale, janë themelore për ofrimin efektiv të shërbimeve. Ndërsa barazia siguron që të gjithë nxënësve të kenë akses të njëjtë në mundësitë e përgjithshme dhe të veçanta arsimore, paanësia/drejtësia siguron, që secili nxënës, të marrë atë që i nevojitet për të përfituar nga këto mundësi.

Treguesit e fushës:

8.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë ndërhyrje, bazuar në njohuritë mbi ndikimet kulturore, të prejardhjes dhe të karakteristikave individuale të nxënësve, për të arritur rezultate optimale të të nxënësve dhe të

sjelljes.

- 8.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, marrin parasysh dallimet individuale, pikat e forta, prejardhjen, talentet dhe nevojat, në vlerësimin dhe në zbatimin e shërbimeve, në mënyrë që të përmirësojnë rezultatet e të nxënit, shëndetin mendor dhe sjelljen, për të gjithë nxënësit, në familje, në shkollë dhe në komunitet.
- 8.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin komunikim gjithëpërfshirës dhe ofrojnë praktika kulturore të përgjegjshme dhe të barabarta, në të gjitha fushat e ofrimit të shërbimeve, për individë të ndryshëm, familje, shkolla dhe komunitete.
- 8.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri të avancuara, në lidhje me arsimin special dhe shërbimet e lidhura me to; ata e përdorin këtë njohuri, për të promovuar praktika të specializuara mësimore dhe mbështetëse, që plotësojnë nevojat e ndryshme të nxënësve me aftësi të kufizuara (AK).
- 8.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me familjet dhe me aktorët e tjerë të komunitetit, për të kuptuar dhe për të adresuar nevojat e nxënësve të ndryshëm.
- 8.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin qasje të bazuar në pikat e forta, për të adresuar nevojat e të nxënit.
- 8.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dhe pranojnë ekzistencën e paragjyqimeve delikate racore, klasore, gjinore, kulturore dhe të tjera që mund të hasin në punën e tyre, dhe ndikimin që ato mund të kenë në vendimet, në ndërveprimet dhe në aktivitetet e tyre profesionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social gjithashtu, janë të vetëdijshëm për ndikimin negativ që kanë paragjykimet, dhe ata bashkëpunojnë me profesionistë të arsimit, për të promovuar respektin për diversitetin, për një mjedis shkolle gjithëpërfshirës dhe mbështetës.
- 8.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dallimet brenda dhe midis grupeve, kur punojnë me popullata të ndryshme nxënësish.
- 8.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë barazi dhe drejtësi sociale në programet dhe në shërbimet arsimore, duke siguruar që të gjithë nxënësit të

mësojnë në mjedise të sigurta, mbështetëse dhe përfshirëse. Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen në mënyrë aktive, në përpjekjet për të adresuar faktorët që kufizojnë barazinë dhe aksesin në mundësitë arsimore.

Fusha 9: Kërkimi dhe puna e bazuar në të dhëna

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar kërkimin, interpretimin e të dhënave dhe vlerësimin e programeve në mjedise të aplikuara; për përdorimin e metodave kërkimore për hartimin e kërkimeve/raporteve/studimeve, për statistikat, për matjen dhe për teknikat e ndryshme të mbledhjes dhe të analizës së të dhënave. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë dhe zbatojnë kërkimin, si bazë për ofrimin e shërbimeve dhe, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, përdorin teknika dhe burime të ndryshme teknologjike, për mbledhjen, për matjen dhe për analizën e të dhënave, për të mbështetur praktikatat efektive tek individ, grupi dhe/ose nivelet e sistemeve.

Treguesit e fushës:

- 9.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë, interpretojnë dhe sintetizojnë gjetjet e grumbulluara të kërkimit dhe i zbatojnë ato si bazë për ofrimin efektiv të shërbimeve.
- 9.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbrojnë përdorimin e të dhënave në praktikatat arsimore në mësimdhënie, në mësimin e aftësive social-emocionale dhe ofrojnë mbështetje pozitive të sjelljes në nivel individual, grupi, shkolle apo njësie vendore arsimore.
- 9.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë njohuritë për ndërhyrjet dhe për programet e bazuara në të dhëna, në vlerësimin, në hartimin dhe në zbatimin me efektivitet të planeve të ndërhyrjes në nivel shkolle.
- 9.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë ndihmë për analizimin, për interpretimin dhe për përdorimin e bazave empirike, për të mbështetur praktikatat efektive të shkollës.
- 9.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë, përzgjedhin dhe interpretojnë strategji të bazuara në të dhëna, që çojnë në përmirësimin kuptimplotë të shkollës, përmes përmirësimit të klimës shkollore, arritjeve në procesin e të nxënës dhe ndjenjës së sigurisë.
- 9.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë njohuritë e tyre, në lidhje me

statistikat dhe me parimet e matjes, për të informuar praktikën e vendimmarrjes.

9.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin parimet e zbatimit të shkencës dhe vlerësimin e programeve dhe i zbatojnë ato në një sërë mjedisesh, për të mbështetur drejtuesit e shkollave në zhvillimin, në zbatimin dhe në monitorimin e programeve, që përmirësojnë rezultatet për të gjithë nxënësit.

Fusha 10: Praktika juridike, etike dhe profesionale

Përshkrimi i fushës

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri për historinë dhe për themelet e shërbimeve psiko-sociale dhe të punës sociale në mjediset shkollore; për modele dhe për metoda të shumta shërbimi; për standardet ligjore, etike dhe profesionale, si dhe për faktorë të tjerë që lidhen me identitetin profesional dhe praktika efektive. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë shërbime, në përputhje me parimet ligjore, etike dhe profesionale; angazhohen në vendimmarrje të përgjegjshme, etike dhe profesionale, bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë dhe aplikojnë karakteristikat e punës profesionale, të nevojshme për praktika efektive, duke përfshirë aftësitë ndërpersonale efektive, përgjegjësinë, përshtatshmërinë, iniciativën, besueshmërinë, kompetencën teknologjike, aftësitë e advokimit, respektimin e diversitetit njerëzor dhe përkushtimin ndaj drejtësisë dhe barazisë sociale.

Treguesit e fushës:

- 10.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin praktika pune, që janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, parimet etike dhe profesionale.
- 10.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përfshihen në marrëdhënie profesionale efektive, bashkëpunuese dhe etike.
- 10.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë dhe përdorin mbikëqyrje profesionale, konsultime me kolegët dhe mentorim/supervizim për praktika efektive sa herë vlerësohet e nevojshme.
- 10.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin zhvillimin profesional të punonjësve të tjerë të shërbimit psiko-social, duke ofruar mbikëqyrje, konsultime me kolegët dhe mentorim/supervizim për ata që kërkojnë një mbështetje të tillë.
- 10.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë dhe përdorin burimet dhe teknologjinë e informacionit, në mënyrë që të mbrojnë dhe të rrisin cilësinë e shërbimeve, sigurinë e informacionit konfidencial dhe mbajtjen e përgjegjshme të regjistrave të të dhënave.
- 10.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë drejtuesit, mësuesit,

personelin tjetër të shkollës dhe prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, në kuptimin dhe në respektimin e legjislacionit dhe të rregulloreve të rëndësishme, për shërbimet e arsimit të përgjithshëm dhe atij special.

- 10.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbrojnë rolin profesional, si ofrues të shërbimeve efektive dhe të praktikave të bazuara në të dhëna, që ndikojnë në rritjen e mundësive për një të nxënë më efektiv dhe përmirësojnë shëndetin mendor të të gjithë nxënësve.
- 10.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social kontribuojnë në mënyrë aktive, në biseda rreth çështjeve me interes publik, duke përdorur deklarata faktike dhe të verifikueshme, që rrisin përdorimin e praktikave dhe të politikave të bazuara në të dhëna.
- 10.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin të dhëna, për të vlerësuar dhe për të dokumentuar efektivitetin e shërbimeve të tyre.
- 10.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe formulojnë plane personale për rritjen e vazhdueshme profesionale.
- 10.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri për standardet që përcaktojnë praktikën bashkëkohore profesionale dhe parimet organizative, për kontekstin e punës së tyre.
- 10.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në aktivitetet e zhvillimit të vazhduar profesional, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të ministrisë përgjegjëse të arsimit dhe të institucioneve të saj të varësisë.
- 10.13. Si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në aktivitetet e rrjeteve profesionale në nivel njësie vendore arsimore, dhe angazhohen në role drejtuese, kur janë të interesuar dhe përmbushin të gjitha kriteret ligjore.
- 10.14. Si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në aktivitetet e njësisë së shërbimit psiko-social në nivel njësie vendore arsimore, dhe angazhohen në role drejtuese, kur janë të interesuar dhe përmbushin të gjitha kriteret ligjore.
- 10.15. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në aktivitetet e zhvillimit të vazhduar profesional, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të Urdhrit të

PJESA II: PARIMET ORGANIZATIVE

Parimi organizues 1: Organizimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve

Shërbimet psiko-sociale gjithëpërfshirëse të shkollës ofrohen nga psikologë shkollorë dhe punonjës socialë, të cilët mund të ushtrojnë profesionin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të Urdhrave përkatëse.

Shërbimet psiko-sociale të shkollës ofrohen në mënyrë të koordinuar, të organizuar, që siguron vazhdimësinë e përsosur të shërbimeve. Shërbimet ofrohen në përputhje me një proces planifikimi strategjik, që merr parasysh nevojat e të gjithë aktorëve dhe përdor një model vlerësimi të programit të bazuar në të dhëna.

- 1.1. Shërbimet psiko-sociale të shkollës planifikohen dhe ofrohen në bazë të një vlerësimi sistematik të nevojave arsimore dhe psiko-sociale të nxënësve. Sistemi arsimor siguron që shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga punonjësit e shërbimit psiko-social, të bazohen në një plan të detajuar veprimtarish. Plani zhvillohet bazuar në nevojat kolektive të sistemit arsimor, të shkollës, të familjes dhe të komunitetit, me fokus parësor nevojat specifike të nxënësve.
- 1.2. Shërbimet psiko-sociale të shkollës janë të disponueshme për të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë. Shërbimet e diferencuara u ofrohen nxënësve, bazuar në nevojën e tyre, statusin e aftësisë së kufizuar ose përshtatshmërinë e arsimit special.
- 1.3. Shërbimet psiko-sociale të shkollës janë të integruara me shërbimet e tjera të shkollës dhe të komunitetit. Nxënësit dhe familjet e tyre nuk duhet të jenë përgjegjës direkt për integrimin e këtyre shërbimeve.

- 1.4. Sistemi arsimor kryen vlerësime të rregullta të ofrimit individual dhe kolektiv të shërbimeve për nxënësit, nga punonjësit e shërbimit psiko-social. Procesi i vlerësimit fokusohet, si në natyrën, ashtu edhe në shtrirjen e shërbimeve të ofruara dhe efektet e tyre te nxënësit.
- 1.5. Sistemi arsimor siguron që punonjësit e shërbimit psiko-social të vlerësohen me metoda dhe me instrumente matëse vlerësimi, që pasqyrojnë trajnimin dhe praktikën e tyre. Vlerësimi i punonjësve të shërbimit psiko-social është i lidhur me “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” dhe pasqyron fushat dhe treguesit përkatës të përshkruara në të.
- 1.6. Sistemi arsimor ofron një sërë shërbimesh për të përmbushur nevojat psiko-emocionale, të arritjeve dhe të sjelljes së nxënësve. Siç tregohet në këtë dokument, punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me personelin tjetër të shkollës, për të ofruar shërbime direkte dhe indirekte për nxënësit dhe për familjet. Përfituesit dhe pjesëmarrësit në këto shërbime, përfshijnë nxënës, mësues, drejtues, oficerë sigurie, personel tjetër të shkollës, familje, ofrues të kujdesit shëndetësor, komunitete të tjera, agjenci lokale dhe rajonale, si dhe burime që mbështesin procesin arsimor.
- 1.7. Sistemi arsimor mbështet ofrimin e shërbimeve këshillimore dhe të tjera nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për mësuesit, për drejtuesit dhe për personelin tjetër të shkollës, me qëllim përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe të mirëqenies së mësuesve.

Parimi organizues 2: Klima

Përgjegjësia i takon sistemit arsimor që të krijojë një klimë, në të cilën shërbimet psiko-sociale të shkollës mund të ofrohen me respekt reciprok për të gjitha palët. Punonjësit kanë lirinë të advokojnë për shërbimet që janë të nevojshme për të përmbushur nevojat e nxënësve, dhe janë të lirë nga kufizimet artificiale, administrative ose politike, që mund të pengojnë ose të ndryshojnë ofrimin e shërbimeve të mënyrë të përshtatshme.

- 1.1. Sistemi arsimor nxit marrëdhënien bashkëpunuese midis anëtarëve të stafit, në një mënyrë që plotëson më së miri interesat e ndërsjella të nxënësve dhe të familjeve. Konfliktet zgjidhen në mënyrë konstruktive dhe profesionale.
- 1.2. Sistemi arsimor ofron një klimë organizative në të cilën punonjësit e shërbimit psiko-social dhe stafi pedagogjik, mund të mbrojnë në mënyrë profesionale shërbimet më të përshtatshme për nxënësit dhe për familjet, pa frikën e ndëshkimit nga mbikëqyrësit ose administratorët.
- 1.3. Sistemi arsimor promovon mjedise pune që rrisin kënaqësinë në punë të punonjësve, në mënyrë që të ruajnë cilësinë e lartë të shërbimeve të ofruara për nxënësit.
- 1.4. Sistemi arsimor promovon dhe advokon ekuilibrin midis jetës profesionale dhe personale të punonjësve të shërbimit psiko-social. Drejtuesit monitorojnë nivelin e punës dhe të stresit të punonjësve dhe ndërmarrin hapa për të zvogëluar presionin, kur mirëqenia e punonjësit është në rrezik. Drejtuesit janë në dispozicion të punonjësve, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, kur faktorët personalë mund të ndikojnë negativisht në performancën e punës dhe kur angazhimet e punës në kushte specifike, mund të ndikojnë negativisht në jetën personale të punonjësit.

Parimi organizues 3: Burimet njerëzore dhe shërbimet mbështetëse

Sistemi arsimor siguron që: **(a)** ekziston një plan i përshtatshëm rekrutimi dhe mbajtjeje për punonjësit, për të siguruar personel adekuat, për të përmbushur nevojat e sistemit; **(b)** të gjitha burimet e financimit, publike dhe private, përdoren dhe maksimalizohen, për të siguruar mbështetjen financiare të nevojshme, për të ofruar shërbimet e duhura; **(c)** të gjithë punonjësit kanë teknologji, burime dhe hapësirë pune të përshtatshme; **(d)** punonjësit kanë përfitime të nevojshme, për të mbështetur punën e tyre, përfshirë zhvillimin profesional të fushës së tyre të kompetencës.

- 3.1. Sistemi arsimor mban përgjegjësi dhe përgjegjshmëri profesionale, për shërbimet e rekrutimit të stafit të kualifikuar dhe të larmishëm, dhe sigurohet se stafi funksionon vetëm brenda fushës së tyre të kompetencës.
- 3.2. Sistemi arsimor mbështet rekrutimin dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar, duke advokuar për raportet e duhura të punonjësve të shërbimit psiko-social ndaj nxënësve. Raporti i punonjësve të shërbimit psiko-social me nxënësit, është një aspekt kritik i ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë dhe gjithëpërfshirëse dhe nuk duhet të kalojë raportin 1:700, një punonjës i shërbimit psiko-social shkollor për çdo 700 nxënës. Në disa situata, raporti punonjës shërbimi psiko-social-nxënës mund të ketë nevojë të jetë më i ulët ose më i lartë. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet, vetëm situata në të cilat punonjësit e shërbimit psiko-social janë caktuar të punojnë kryesisht, me popullatën e nxënësve që kanë nevoja të veçanta intensive (p.sh. shkollat speciale), me numrin e institucioneve arsimore të mbuluara, me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar në një shkollë të caktuar etj.
- 3.3. Sistemi arsimor ofron burime të avancuara teknologjike, për të lehtësuar menaxhimin efektiv të kohës, sistemet e komunikimit, sistemet e menaxhimit të të dhënave dhe ofrimin e shërbimeve.
- 3.4. Sistemi arsimor u siguron punonjësve të shërbimit psiko-social të shkollave, qasje në materialet e duhura profesionale të punës, zyrë dhe ambient të përshtatshëm pune, teknologji të përshtatshme, kushte të përgjithshme pune që rrisin ofrimin e shërbimeve efektive dhe sigurojnë konfidencialitetin, materiale të vlerësimit dhe të ndërhyrjes, si dhe qasje në literaturën profesionale dhe bashkëkohore.

Parimi organizues 4: Komunikimi profesional

Sistemi arsimor siguron politika dhe praktika që rezultojnë në komunikim pozitiv, proaktiv, midis punonjësve në të gjitha nivelet administrative të institucionit arsimor parauniversitar.

- 4.1. Sistemi arsimor ofron mundësi që punonjësit të komunikojnë me njëri-tjetrin, në lidhje me çështjet me interes të ndërsjellë profesional në baza të rregullta.

- 4.2. Sistemi arsimor mbështet dhe promovon qasje bashkëpunuese, për zgjidhjen e problemeve në planifikimin dhe në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale të shkollës.
- 4.3. Sistemi arsimor siguron që anëtarët e stafit të kenë akses në teknologjinë e nevojshme, për të kryer punën e tyre në mënyrë adekuate dhe për të mbajtur komunikimin e duhur dhe konfidencial me nxënësit, me familjet dhe me ofruesit e shërbimeve brenda dhe jashtë sistemit.
- 4.4. Politika e sistemit arsimor mbi bazën e të dhënave të nxënësve, është në përputhje me ligjet dhe rregulloret shtetërore dhe siguron mbrojtjen e konfidencialitetit të nxënësve dhe të familjeve të tyre. Aktet ligjore dhe nënligjore për përpunimin dhe për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive, specifikojnë llojet e të dhënave që klasifikohen si të tilla. Aktet ligjore dhe nënligjore japin udhëzime të qarta, në lidhje me dokumentet që i përkasin shkollës dhe ato që i përkasin nxënësit/prindit/personit që ushtron përgjegjësinë prindërore dhe dokumentet që i përkasin punonjësit të shërbimit psiko-social. Aktet ligjore dhe nënligjore për përpunimin dhe për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive, përfshijnë procedura për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të privatësisë së nxënësve në përdorimin e komunikimeve elektronike.

Parimi organizues 5: Mbikëqyrja/supervizimi, konsultimi me kolegët dhe mentorimi

Sistemi shkollor siguron që i gjithë personeli të ketë mundësi për supervizim, konsultim me kolegët dhe mentorim të përshtatshëm, për të siguruar ofrimin e shërbimeve efektive dhe të përgjegjshme. Supervizimi dhe mentorimi sigurohen përmes një procesi të vazhdueshëm, pozitiv, sistematik, bashkëpunues midis punonjësit të shërbimit psiko-social dhe një supervizori ose kolegëve të tjerë të shërbimit psiko-social gjatë gjithë karrierës. Në rastet kur në nivel njësie vendore arsimore, plotësohet numri i punonjësve të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore, supervizorët mund të jenë të ndarë sipas fushave të kompetencës (psikologë shkollorë dhe punonjës socialë). Ky proces fokusohet në nxitjen e rritjes profesionale dhe praktikën profesionale, që çon në përmirësimin e performancës të të gjithë

pjesëmarrësve, përfshirë psikologun e shkollës/punonjës social, supervizorin, nxënësit dhe të gjithë komunitetin shkollor.

- 5.1. Individët që angazhohen në supervizim profesional ose administrativ, të punonjëve të shërbimit psiko-social të shkollës, përmbushin kriteret sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për mjedisin në të cilin ata janë të punësuar, dhe kanë një minimum prej 3 vitesh, përvojë pune në profesion.
- 5.2. Metodatat e supervizimit duhet të përputhen me përvojën, me kompetencat dhe me nevojat e shërbimit psiko-social. Praktikantët (studentët gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale) dhe punonjësit e shërbimit psiko-social fillestarë kërkojnë supervizim më intensiv, duke përfshirë seanca të planifikuara rregullisht ballë për ballë. Metodatat alternative, të tilla si: grupet e supervizimit, mentorimi, aktivitetet e rrjeteve profesionale, aktivitetet e njësisë së shërbimit psiko-social në nivel lokal dhe/ose konsultimi me kolegët, mund të përdoren nga punonjës të shërbimit psiko-social më me përvojë, për të siguruar rritje të vazhdueshme profesionale dhe mbështetje për raste komplekse ose të vështira.
- 5.3. Sistemi arsimor duhet të zhvillojë dhe duhet të zbatojë një plan të koordinuar për përgjegjshmërinë dhe për vlerësimin e të gjitha shërbimeve psiko-sociale të shkollës. Ky plan duhet të adresojë zbatimin e vlerësimit dhe rezultatet e shërbimeve.
- 5.4. Sistemi arsimor harton dhe zbaton një plan në koordinim me punonjësit e shërbimit psiko social shkollor për të siguruar ndërhyrje gjithpërfshirëse dhe sa më cilësore.
- 5.5. Supervizorët sigurojnë udhëheqje profesionale, përmes pjesëmarrjes së tyre në organizma profesionale të shërbimit psiko-social dhe përfshirjes aktive në zhvillimin e politikave arsimore.

Parimi organizues 6: Zhvillimi i vazhduar profesional dhe sistemet e njohjes

Punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollave kryejnë aktivitete të zhvillimit profesional çdo vit. Sistemi shkollor siguron që zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit të tij, është i përshtatshëm dhe në përputhje me prioritetet e ofrimit të shërbimeve. Sistemi arsimor njih nevojën për një sërë disiplinash dhe aktiviteteve specifike të zhvillimit profesional. Aktivitete të tilla mund të përfshijnë ato të siguruar nga sistemi arsimor, si aktivitetet nga institucionet e varësisë së ministrisë përgjegjëse për arsimin, rrjetet profesionale apo të njësisë së shërbimit psiko-social dhe ofruesit e aktiviteteve të zhvillimit të vazhduar profesional, të miratuar nga Urdhrat përkatëse të profesioneve ose të organizatave të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e edukimit.

- 6.1. Sistemi arsimor mundëson ngritjen e strukturave të zhvillimit të vazhduar profesional në nivel lokal, siç janë rrjetet profesionale, njësia e shërbimit psiko-social në nivel lokal e rajonal, dhe i mbikëqyr dhe i vlerëson ato vazhdimisht, sipas parashikimeve në udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës për arsimin.
- 6.2. Sistemi arsimor siguron mbështetje (trajnime, kohë, mbikëqyrje etj.), që punonjësit e shërbimit psiko-social të kenë qasje të mjaftueshme në zhvillimin e vazhdueshëm profesional në një nivel të nevojshëm, për t'u njohur me zhvillimet dhe me praktikat profesionale aktuale, me qëllim që të përfitojnë nxënësit, familjet, shkollat dhe komunitetet. Sistemi shkollor siguron teknologji dhe burime personeli, për të ndihmuar sistemin, për dokumentimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional.
- 6.3. Sistemi arsimor siguron mundësinë që punonjësit e shërbimit psiko-social të krijojnë dhe të ndjekin planet personale për zhvillimin profesional, që mundësojnë përvetësimin e njohurive, të kompetencave dhe të aftësive të reja. Supervizimi i mbështetur nga sistemi arsimor, vë në dispozicion mundësitë për t'i dhënë *feedback-un* punonjësve të shërbimit psiko-social, në lidhje me cilësinë e aftësive të përvetësuar.



BIBLIOGRAFIA

Australian Psychological Society. (2016). The framework for effective delivery of school psychology services: a practice guide for psychologists and school leaders. APS.

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (2020). Rregullore “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Tiranë.

National Association of School Psychologists. (2020). Model for Comprehensive and Integrated School Psychological Services. NASP.

Udhëzimi nr. 4, datë 11.4.2016 “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”.

Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tirana
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441
